



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Nr. 107  
Dt. 17.09.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISHTINA  
DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË-DIREKCIJA ZA PRISHTIVU IŠTAŠTVO

03 107 14.09.2018

### DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë dispozitave të nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi edukimin parashkollor, nenin 3 të UA Nr. 41/2007, dt. 9.10. 2007 Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, nenit 4, paragrafi 5 të UA Nr. 19/2016 Për përfshirjen e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë, nenin 2, paragrafi 2.3 të Rregullores 01 nr. 110-157460, dt. 01.07.2014 Për të hyrat vetanake të Institucioneve Arsimore, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë së Arsimit publikon këtë:

### NJOFTIM

I. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore për vitin shkollor 2018-2019.

#### Të drejtë lirimi nga pagesa kanë vetëm:

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%;
- b) Fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) 100%;
- c) Fëmijët me nevoja të veçanta 100%;
- d) Fëmijët në asistencë sociale 100%;
- ç) Fëmijët me njërin prind lirohen 100%;
- d) Fëmijët e veteranëve të luftës 100%;
- e) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do ta paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

II. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet ti paraqesin këto dokumente:

Faqe 1 nga 3

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2018-2019;
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve;
- Kopjen kontratës me IP.

***Invalidët e luftës duhet t'i paraqesin edhe:***

- Vendimin origjinal (ose kopjen e vërtetuar të noteri) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës;

***Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:***

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale).

***Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale edhe:***

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë në asistencë sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

***Kujdestaret fëmijëve bonjakë (pa të dy prindërit) edhe:***

- Certifikatën e vdekjes se prindërve (origjinale)

***Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:***

- Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/ës (origjinale)

***Prindi vetëushqyes edhe:***

- Dokumentin zyrtar se jeni prind vetëushqyes.

***Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar ne çerdhet publike edhe:***

- Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.

**VËMENDJE:** Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirimit, në të kundërtën e njëjta do të refuzohet.

**III.** Lirimi nga pagesa, bëhet nga 1 shtatori i vitit 2018 deri më 31 Gusht 2019.

**Kërkesat dorëzohen në administratën e IP-së përkatëse.**


**Afati për paraqitjen e kërkesës është nga dt. 17.09.2018 deri më dt. 28.09.2018**

Në publikimin e listës në tabelën e shpalljes në IP, **udhëzohet pala e pakënaqur** se ka të drejt të paraqet ankesë për rishqyrtimin e vendimit të komisionit, **në IP-në përkatëse, në afat prej tri (3) ditëve**, jo në Drejtorinë e Arsimit.

Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të bëjnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë në afat prej tetë (8) ditëve. DKA nuk shqyrton asnjë ankesë nëse e njëjta fillimisht nuk është paraqitur në IP-në përkatëse.

**Vërejtje:** Te gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të paraparë në këtë njoftim nuk do të shqyrtohen.

**17 shtator 2018**

**Drejtor**  
  
Jonuz Salihaj